

Lutja


duke kompozuar:

Dr. Abdul Muhsin bin Muhamed Al Kasim

Imam dhe hatib në xhaminë e Profetit

Lutja

Për të shkarkuar librin skano barkodin:



a-alqasim.com

Lutja

duke kompozuar:

**Dr. Abdul Muhsin bin Muhamed
Al Kasim**

Imam dhe hatib në xhaminë e Profetit

Parathënie

Falenderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botërave, falja (salavatet) dhe paqja (selami) e Tij qofshin mbi Profetin Muhamed ﷺ, familjen dhe shokët e tij.

Allahu i Lartësuar i ka krijuar njerëzit dhe xhindët që ta adhurojnë Atë, e prej mirësive të Tij karshi krijesave është që Ai i ka dhënë mundësinë atyre që të kryejnë adhurime të ndryshme; prej të cilave ka adhurime që lidhen me veprat e zemrës, siç janë mbështetja tek Ai dhe frika ndaj Tij, e prej të cilave ka edhe adhurime të dukshme siç janë namazi e zekati.

Esenca e çdo adhurimi është lutja, e cila ka një rëndësi tepër të madhe në fe dhe argumentet që tregojnë për vlerën dhe pozitën e saj të lartë, nxisin për të dhe sqarojnë rregullat e saj, janë të shumta.

Lutja është ibadet që të gjithë njerëzit e kanë të domosdoshëm, megjithëse gjendjet e gradat i kanë të ndryshme.

Ai i cili është i sinqertë në lutjen e tij, dhe e kryen atë sipas sunetit të Profetit ﷺ, ka kryer një ibadet të madh, dhe shpresohet që t'i pranohet lutja, ndërsa ai i cili e neglizhon lutjen, ose e shoqëron atë

me diçka të ndaluar, ose zemra e tij gjatë lutjes lidhet me dikë tjetër veç Allahut; ka humbur një ibadet të madh, e nuk e ka arritur objektivin e lutjes dhe është i ekspozuar ndaj ndëshkimit të Allahut.

E për shkak të rëndësisë së lutjes dhe nevojës së njeriut për të, kam përmbledhur në këtë material disa çështje, tema e të cilave është që lutja të mos i drejtohet askujt tjetër veç Allahut, ndaj e kam quajtur këtë libërth: “**Lutja**”.

Lus Allahun që t’a bëj atë të sinqertë për Fytyrën e Tij e të dobishëm për njerëzit.

Falja (salavatet) dhe paqja (selami) e Tij qofshin mbi Profetin Muhamed ﷺ, familjen e shokët e tij.

Dr. Abdul Muhsin bin Muhamed Al Kasim

Imam dhe hatib në xhaminë e Profetit ﷺ

Shkruajtur dt. 20/2/1444 (hixhri)

Feja islame në thelb është kryerja e veprave me sinqeritet vetëm për Allahun

Feja e Allahut të cilën e ka zgjedhur për krijesat – nga i pari tek i fundit – është Islami, fe me të cilën janë dërguar të gjithë profetët, dhe e kanë ngritur flamurin e tij të gjithë të dërguarit, sikurse Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ﴾

“Feja e vetme e pranuar tek Allahu është Islami”. [Ali Imran: 19]

Islami është t’i drejtohesh Allahut me sinqeritet dhe nënshtrim ndaj Tij si Krijues, Rregullues e Posedues të çdo gjëje, si dhe si Zot, që vetëm Ai meriton të adhurohet.

Islami është feja e pastër e Ibrahimit (alejhi selam):

﴿ثُمَّ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ أَنْ اتَّبِعْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا

وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ﴾

“Pastaj, ty të shpallëm: Ndiqe fenë e drejtë të Ibrahimit, se ai nuk ka qenë nga idhujtarët”. [en Nahl: 123].

Islami është besim (akide) dhe legjislacion (shariat), dituri dhe punë, e dukshme që vërteton atë çka është në zemër.

Fjala “La ilahe il-la Allah (Nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut)” është esenca dhe baza e Islamit, fillimi dhe fundi i tij, shkak dhe objektivi, dhe kupola e fortesës së tij më të cilën zbukurohet e përsoset.

Kuptimi i saj është si rëndësia e shpirtit për trupin, e nuk ka dobi nga trupi nëse shpirti nuk gjendet në të.

Shqiptimi i saj duke mos besuar në kuptimin e saj nuk i bën dobi njeriut.

Ajo është një fjalë që përfshin të gjithë fenë, kush e thotë duke ja ditur kuptimin e duke plotësuar kushtet e kërkesat e saj; e ka realizuar teuhidin (njësimin e Allahut), e kush e realizon teuhidin sikurse e ka obliguar Allahu do të hyjë në Xhenet pa llogari e pa ndëshkim.

Feja Islame bazohet mbi lutjen e Allahut, e askujt tjetër veç Tij

Treguesi më i qartë i teuhidit (njësimit të Allahut) nga ana e njeriut është lutja e Allahut e askujt veç Tij.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: ***“Kur të kërkosh diçka; kërkো vetëm nga Allahu”***. [Tr. Tirmidhiu (2516) nga Ibn Abbasi].

Feja Islame bazohet veçse në veçimin e Allahut me lutje, e me këtë bazë Allahu ka dërguar profetët e ka zbritur librat.

Veçimi i Tij me lutje është feja e Tij të cilën Ai do që njerëzit t'a shfaqin, edhe nëse nuk i pëlqen jobesimtarëve.

﴿فَادْعُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ﴾

“Luteni Allahun singerisht, duke ja dedikuar Atij fenë edhe pse jobesimtarët e urrejnë atë (adhurimin)”. [Gafir: 14].

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar e ka urdhëruar Profetin Muhamed ﷺ të lajmëroj popullin e tij se feja e Tij bazohet në njësimin e Allahut në lutje.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ قُلْ إِنَّمَا أَدْعُوا رَبِّي وَلَا أُشْرِكُ بِهِ أَحَدًا ﴾

“Thuaj: Unë i lutem vetëm Zotit tim, e Atij nuk i bëj asnjë shok në adhurim!”. [el Xhinn: 20].

Ndëshkimi i atij që është mendjemadh karshi lutjes së Allahut

Allahu i Lartësuar ka kërcënuar me zjarrin e Xhehennemit dhe me nënçmim cilindo që tregohet mendjemadh e kryeneç ndaj lutjes së Tij:

﴿إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ﴾

“Ata që janë mendjemëdhenj karshi adhurimit Tim do të hyjnë të nënçmuar në xhehennem”. [Gafir: 60].

Ai i cili me zemrën e tij urren t’i lutet Allahut, nuk gjen qetësi veçse duke ju lutur krijesave, e kjo është shenja e humbjes dhe mosinteresimit ndaj ahiretit (botës tjetër), sikurse Allahu thotë:

﴿وَإِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَحْدَهُ اشْمَأَزَّتْ قُلُوبُ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ﴾

“Kur përmendet vetëm Allahu, zemrat e atyre që nuk besojnë botën tjetër neveriten”. [ez Zumer: 45].

Pra, zemrat e tyre neveriten sepse nuk mund të pranojnë që Allahu të veçohet me adhurime e lutje.

Lutja është i gjithë adhurimi

Nuk ka situatë që lidhet me imanin që Allahu i'a ka obliguar zemrave, veçse kërkohet në të lutja.

Adhurimet e dukshme e të fshehta përmbajnë lutje; personi i cili falet, agjëron, bën haxhin apo jep sadaka është duke ju lutur Allahut praktikisht, adhurimi që ai kryen, nënshtrimi e dashuria e tij ndaj Allaut tregojnë që ai i lutet Allahut që t'ia pranoj veprën që ka kryer, e kërkon të jetë më afër me Allahun.

Pra, lutja është esenca, baza dhe thelbi i adhurimit, sikurse thotë i Dërguari i Allahut ﷺ: **“Duaja është i gjithë adhurimi”**, e më pas lexoi fjalën e Allahut:

﴿وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ﴾

“Zoti juaj ka thënë: M’u lutni mua, t’ju Përgjigjem”. [Tr. Ahmedi (18432) nga Nu’man bin Beshiri].

Rëndësia e dedikimit të lutjes vetëm Allahut

Për shkak të pozitës së lartë të lutjes, Allahu e ka filluar Librin e Tij me lutje, duke thënë:

﴿أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ﴾

“Na udhëzo në rrugën e drejtë”. [el Fatiha: 6].

E poashtu, e ka mbyllur atë me dy suret e fundit në të cilat kërkohet mbrojte nga Allahu, e në to ka lutje gjithashtu.

Allahu në Librin e Tij e ka quajtur lutjen fe, duke thënë:

﴿فَادْعُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ﴾

“Luteni Allahun sinqerisht, duke ja dedikuar Atij fenë”. [Gafir: 14].

E ka emërtuar gjithashtu adhurim, duke thënë:

﴿وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ﴾

﴿عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ﴾

“Zoti juaj ka thënë: Lutmuni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit Tim, do të hyjnë të nënçmuar në xhehennem”. [Gafir: 60].

Lutja e Allahut është tregues i imanit

Sinçeriteti ndaj Allahut duke ja dedikuar lutjen veç Atij është tregues i imanit, argument i bindjes së plotë, litar i shpëtimit, shkak i shpëtimit, si dhe shenjë dalluese e profetëve dhe besimtarëve.

Lutësi që i drejtohet me lutjen e tij vetëm Allahut është adhurues i sinçertë dhe njohës i saktë i rrugës së drejtë, pasi që lutja është shtylla e fortë tek e cila mbështeten besimtarët dhe streha e sigurtë e cila mbron ata që janë në nevojë.

Fatkeqsitë bëjnë që njeriu t'a njoh Zotin e tij, dhe e çojnë atë drejt lutjes së Allahut me sinçeritet.

﴿وَإِذَا مَسَّ الْإِنْسَانَ الضُّرُّ دَعَانَا لِجَنبِهِ أَوْ قَاعِدًا أَوْ قَائِمًا﴾

“E kur njeriu e godet dëmi, ai na lutet qoftë shtrirë, ulur ose në këmbë”. [Junus: 12].

Vetëm Allahu i përgjigjet lutjes

Zoti ynë i Lartësuar është i Vetmi të Cilit i dedikohen lutjet në çdo kohë e rrethanë; Ai është Krijuesi që nuk e pengon asgjë, i Plotëfuqishmi dhe Sunduesi i gjithçkaje, furnizimi është në Dorën e Tij, dhënia e ndërpreja e furnizimit është vetëm nga Ai.

Cilësitë e Allahut që tregojnë përsosmërinë e Tij janë attribute të përherëshme të Tij, e kush i drejtohet Atij duke iu lutur me emrat dhe cilësitë e Tij; Ai i jep atë që kërkon.

﴿وَلِلَّهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا﴾

“Allahu ka emrat më të mirë, andaj Atë thirreni me ta”. [el A’raf: 180].

Zoti ynë është afër atij që e lut Atë dhe e adhuron, nëse dikush ka një hall dhe i drejtohet Allahut; Ai i jep zgjidhje, e kush i lutet Atij; Ai i përgjigjet.

﴿وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ﴾

“E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet”. [el Bekare: 186].

Ai është i Përjetshmi e të gjithë kanë nevojë për Të. Kur dikush i lutet Atij; i është drejtuar Zotit të Vetëm i Cili mund të zgjidh të gjitha hallet e krijesave.

﴿هُوَ الْحَيُّ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَادْعُوهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ﴾

“Ai është i Përjetshmi, s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Tij, luteni Atë me sinqeritet në fe”. [Gafir: 65].

Vetëm Allahu meriton që t’i drejtohen lutjet, e askush tjetër veç Tij, e ky është argument që lutja e dikujt tjetër veç Allahut nuk pranohet, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

﴿لَهُ دَعْوَةُ الْحَقِّ وَالَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ لَا يَسْتَجِيبُونَ لَهُمْ بِشَيْءٍ﴾

“Lutja e vërtetë është vetëm ajo që i drejtohet Atij, e ata që i luten të tjerëve veç Tij, ata nuk i përgjigjen atyre për asgjë”. [er Ra’d: 14].

Ajo çka Ai jep mahnit këdo, bujaria e Tij është e çuditshme, Ai për vepra të vogla shpërblen me mirësi të shumta. Nëse dikush e lavdëron dhe i kërkon në mënyrën e duhur, Ai i jep me bujari, ia fal gjynahet sado të mëdha qofshin ato, nëse njeriu adhuron Allahun e nuk i bën Atij shok në adhurim, sikurse thotë Allahu në hadithin kudsij: **“Kush më**

*takon mua me gjynahe sa e gjithë toka duke mos
bërë shirk: do ta takoj atë po me aq falje*". [Tr.
Muslimi (2687) nga Ebu Dherri].

Profetët nuk lusin veçse Allahun

Njerëzit më të dashur tek Allahu janë ata të cilët i luten Atij më së shumti e i përgjërohen, e sa më shumë të shtohet dhe forcohet besimi, kuptimi i fesë dhe lidhja e njeriut me Zotin aq më shumë shtohet dhe forcohet dëshira e zelli i tij në lutjet që bën.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: ***“Le të kërkoj dikush prej jush nga Zoti i tij çdo gjë që i nevojitet, derisa t’i lutet Allahut për lidhësen e këpucës kur këputet”***. [Tr. Tirmidhiu (3608) nga Enes bin Malik].

Shejhul Islam Ibn Tejmije ka thënë: “Profetët dhe pasuesit e tyre i luteshin Allahut për çdo gjë të dobishme të fesë, dunjasë dhe botës tjetër, e cili është ai i cili nuk ka nevojë të kërkoj nga Allahu i Lartësuar?!

Prej veçorive të njeriut është që ai kërkon nga Zoti i tij, e prej veçorive të Allahut është që ai i përgjigjet atij që i lutet, e kush mendon se nuk ka nevojë të kërkoj nga Allahu ka dalë nga petku i adhurimit”.

Të dërguarit e Allahut i luteshin Allahut në çdo gjendje:

﴿إِنَّهُمْ كَانُوا يُسْـَٔرِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا
وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خَشِيعِينَ﴾

“Ata garonin për punë të mira, Na luteshin me shpresë e frikë, e ishin të frikësuar ndaj Nesh”. [el Enbija: 90].

Zekerija (alejhi selam) dëshironte shumë që të kishtë fëmijë; ai i kërkoi Allahut që t'i jepte pasardhës të mirë dhe e lavdëroi Atë duke thënë:

﴿إِنَّكَ سَمِيعُ الدُّعَاءِ﴾

“Ti je Dëgjuesi i lutjeve”. [Ali Imran: 38], e më pas shkoi tek vendi i faljes, ku aty melaiket e përgëzuan atë me një Profet nga pasardhësit e tij, megjithëse ai ishte i madh në moshë dhe dhe i pafuqishëm.

Nuhu (alejhi selam) u kundërshtua dhe përgënjeshtua nga populli i tij:

﴿فَدَعَا رَبَّهُ أَنِّي مَغْلُوبٌ فَأَتَّصِرُ﴾

“E ai iu drejtua Zotit të vet: Unë jam i mundur, prandaj më ndihmo!”. [el Kamer: 10].

Dhe Allahu e përmbyti mbarë tokën, duke mos shpëtuar askush veç atyre që besuan me Nuhin

(alejhi selam).

Allahu na ka treguar historinë e banorëve të shpellës, ku disa të rinj që besuan dhe nuk i bënë Allahut shok në adhurim, dhe duke e ditur se lutja e Allahut, e askujt tjetër veç Tij ishte feja e vetme të cilën Allahu e pranon, i thanë popullit të tyre:

﴿رَبُّنَا رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ لَن نَدْعُو مِنْ دُونِهِ إِلَهًا
لَقَدْ فَلْنَا إِذَا شَطَطًا﴾

“Zoti ynë është Zot i qiejve e i tokës, nuk i lutemi askujt veç Tij, sepse atëherë do të thoshim diçka shumë mizore!”. [el Kehf: 14].

Dhikri i përhershëm i besimtarëve është: lutja gjatë mëngjesit, mbrëmjes, e gjatë natës:

﴿تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا
وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ﴾

“I heqin trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa dhe nga ajo që Ne ua kemi dhënë (pasuria) atyre, ata japin”. [es Sexhde: 16].

Qëndrimi me ata të cilët i luten Allahut shpesh është prej gjërave me të cilat Allahu i Lartësuar ka

urdhërar të Dërguarin e Tij:

﴿وَأَصْبِرْ نَفْسَكَ مَعَ الَّذِينَ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ بِالْغَدَاةِ وَالْعَشِيِّ
يُرِيدُونَ وَجْهَهُ﴾

“Përkufizoje veten tënde me ata që e lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë e Fytyrës së Tij”. [el Kehf: 28].

Dobitë e lutjes së Allahut

Dobitë e lutjes janë të shumta, e mirësia e saj është e madhe, nga ajo përfitojnë të gjallët e të vdekurit, dhe bereqeti i saj përfshin lutësin dhe atë për të cilin është bërë lutje.

Lutja është shkak sikurse shkaqet e tjera, ndaj njeriu i lutet Allahut sipas asaj që Allahu ka caktuar, e Ai i përgjigjet lutjes së tij sipas dëshirës së Tij.

Lutja largon fatkeqsinë nëse ka qenë e caktuar, dhe sjell mirësi e shpëton nga të kqijat. Pra; çdo gjë është nga Allahu dhe tek Ai, e askush nga njerëzit nuk mund të ndryshoj vendimin e Tij.

Lutja me siguritë e Allahut është dritë, ajo mohon ekzistencën e çfarëdo lloj rivali, ortaku, bashkëpuntori, apo të adhuruari tjetër veç Allahut. Me anë të saj lutësi bëhet rob i Allahut, e njëson Atë në madhërim, dashuri, frikë, shpresë dhe për çdo gjë i drejtohet vetëm Atij, zemra e tij lidhet me Allahun në gëzime e hidhërimë dhe gjuha e tij i lutet Allahut në çdo gjendje.

Prej shenjave të personit që e njëson Allahun

Kush dëshiron të njoh saktësinë e teuhidit le të shoh se cilit i lutet; nëse i lutet vetëm Allahut atëherë teuhidi i tij është i saktë.

E nëse i lutet dikujt tjetër veç Allahut atëherë ai ka rënë në shirk.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ﴾

“E kush lut me Allahun ndonjë zot tjetër, për të cilin nuk ka kurrfarë fakti, llogaria e tij është para Zotit të vet, e mohuesit (jobesimtarët) nuk do të shpëtojnë”. [el Mu’minun: 117].

Profetët e Allahut nuk kanë urdhëruar askënd që t’u lutet atyre

Përsosmëria absolute i takon vetëm Allahut dhe të gjitha adhurimet i takojnë vetëm Atij, e askush nuk meriton të adhurohet veç Tij.

Askush nga njerëzit – sado e lartë të jetë grada e tij – nuk meriton të adhurohet veç Allahut.

Ai i cili nuk ka mundësi të krijoj qoftë edhe një krijesë të vogël kurrsesi nuk meriton të adhurohet apo t’i dedikohet lutja:

﴿إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَنْ يَخْلُقُوا ذُبَابًا وَلَوْ اجْتَمَعُوا لَهُ﴾

“Ata që po i adhuron në vend të Allahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të”. [el Haxh: 73].

Allahu i Lartësuar ka përzgjedhur prej njerëzve të dërguarit dhe i ka veçuar ata nga të tjerët. Asnjë prej tyre nuk ka pretenduar se është Zot, apo të ketë kërkuar që lutjet t’i drejtohen atij apo të ketë qenë dakord me diçka të tillë:

﴿وَأَذَّ قَالَ اللَّهُ يَعْيسَى ابْنَ مَرْيَمَ ءَأَنْتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمَّيَ إِلَهَيْنِ
 مِنْ دُونِ اللَّهِ قَالِ سُبْحَانَكَ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِي بِحَقِّ﴾

“Dhe kur Allahu tha: O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: Më besoni mua dhe nënën time dy zota pos Allahut!? (Isai) Tha: Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s’është e vërtetë”. [el Maide: 116].

Të dërguarit e Allahut mund të preken nga sëmundjet dhe fatkeqësitë; ka nga ata që janë vrarë, që i ka kapur sëmundja, apo i është bërë magji. Ata -si të gjithë njerëzit e tjerë - hanë ushqim; e si mund të meritoj të adhurohet dikush që nuk jeton dot pa ushqim?!

Edhe krijesës më të dashur te Allahut, Profetit Muhamed ﷺ; i është thyer dhembë, i është çarë koka, është rrëzuar nga kali e i është rrjepur lëkura saqë është falur i ulur, nga dhimbjet e forta.

Lutja e dikujt tjetër veç Allahut është gjynahu më i madh

Lutja e dikujt tjetër veç Allahut është gjynah madhor, Allahu i drejtohet Profetit ﷺ duke thënë:

﴿وَلَا تَدْعُ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَنْفَعُكَ وَلَا يَضُرُّكَ
فَإِنْ فَعَلْتَ فإِنَّكَ إِذَا مِنَ الظَّالِمِينَ﴾

“Mos lut veç Allahut tjetërkënd që nuk të sjell as dobi e as dëm, e nëse e bën atë, atëherë do të jesh prej zullumqarëve”. [Junus: 106].

E prej llojeve më të mëdha të gjynahut është bërja e dikujt ndërmjetës mes Allahut dhe njeriut.

Shejhul Islami Ibn Tejmije thotë: “Profetët nuk i kanë lejuar askujt që të kërkoj ndihmë, t’i lutet apo t’i kërkojnë ndërmjetësim tek Allahu, qofshin ata nga njerëzit e mirë – të vdekur qofshin apo joprezentë –, apo melaïke (ëngjëj). Kjo është origjina e shirkut, pasiqë mushrikët i bënë idhujt e tyre si ndërmjetësues mes tyre dhe Allahut. Thotë Allahu i Lartësuar:

﴿وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ
شُفَعَاؤُنَا عِنْدَ اللَّهِ﴾

“Ata adhurojnë veç Allahut çka nuk i bën dëm e as dobi, e thonë: Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu!”. [Junus: 18]”.

Gjynahu më i madh është që njeriu t’i lutet dikujt tjetër bashkë me Allahun.

Ibn Mes’udi ﷺ tregon se e pyeti Profetin ﷺ: “cili është gjynahu më i madh?”.

Profeti ﷺ iu përgjigj: **“T’i shoqërosh Allahut rival, ndërkohë që Ai të ka krijuar”**. [Tr. Buhariu (4477 dhe Muslimi (86)].

Allahu ka kërcënuar këdo që i lutet tjetër kujt veç Tij me dënim duke thënë:

﴿فَلَا تَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ فَتَكُونَ مِنَ الْمُعَذِّبِينَ﴾

“Përveç Allahut mos lut zot tjetër, e të bëhesh prej të dënuarve”. [esh Shu’ara: 213].

Ibn Abbasi (radijallahu anhuma) e komenton ajetin duke thënë: “Allahu paralajmëron njerëzit me këtë ajet duke iu drejtuar Profetit ﷺ duke i thënë: Ti je krijesa më e dashur për Mua, e nëse adhuron dikë tjetër veç Meje do të dënohesh”.

Namazi, rukuja, sexhdeja, e ndërtimi i xhamive nuk janë ligjëruar e kërkuar veçse që lutja t’i drejtohet Allahut e askujt tjetër veç Tij. Allahu i

Lartësuar thotë:

﴿وَأَنَّ الْمَسْجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا﴾

“Xhamitë janë për të adhuruar vetëm Allahun, e mos lutni dikë tjetër veç Tij”. [el Xhinn: 18].

I vdekuri nuk dëgjon nëse dikush i lutet

Lutësi i drejtohet Krijuesit, e nuk i lutet krijesave që janë si ai, e as nuk kërkon ndihmë nga dikush që është rob i Allahut (njeri).

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ نَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ عِبَادٌ أَمْثَلُكُمْ فَادْعُوهُمْ
فَلَيْسَ تَجِيبُوا لَكُمْ إِنَّ كُنْتُمْ صَادِقِينَ﴾

“S’ka dyshim se ata që ju i luteni veç Allahut, janë njerëz sikurse ju. Lutjunu atyre, e le t’ju përgjigjen juve nëse po thoni të vërtetën.”. [el A’raf: 194].

I vdekuri nuk e dëgjon lutjen që i bëhet, edhe nëse lutësi e konsideron atë si Zot, e nuk mund t’a ndihmoj lutësin edhe nëse ai mendon se i vdekuri posedon veçoritë e Allahut, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

﴿وَالَّذِينَ نَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ مَا يَمْلِكُونَ مِنْ قِطْمِيرٍ *
إِنَّ تَدْعُوهُمْ لَا يَسْمَعُوا دُعَاءَكُمْ وَلَوْ سَمِعُوا مَا اسْتَجَابُوا لَكُمْ﴾

“E ata që ju i luteni në vend të Allahut, nuk posedojnë as sa një cipë të hurmës. Nëse i luteni, ata

nuk dëgjojnë thirrjen tuaj, e nëse do e dëgjonin, nuk mund t’ju përgjigjen”. [Fatir: 13-14].

Cilido i vdekur qoftë, nuk ka mundësi të ndihmoj veten e tij, e jo më të ndihmoj të tjerët, kjo është e pamundur. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَالَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ لَا يَسْتَجِيبُونَ نَصَرَكَمْ وَلَا أَنْفُسَهُمْ يَنْصُرُونَ﴾

“Ata që ju i luteni veç Allahut, ata nuk kanë mundësi për ndihmë ndaj jush, e as veten e tyre nuk mund ta ndihmojnë”. [el A’raf: 197].

Ai i cili i lutet të vdekurit është i bindur që i vdekuri nuk dëgjon e nuk mund të sjell dobi

Ai i cili i lutet të vdekurit është i bindur që lutja e tij nuk dëgjohej e as nuk i sjell atij dobi.

Ibrahimi (alejhi selam) iu drejtua popullit të tij në lidhje me idhujt që ata adhuronin:

﴿قَالَ هَلْ يَسْمَعُونَكُمْ إِذْ تَدْعُونَ * أَوْ يَنْفَعُونَكُمْ أَوْ يَضُرُّونَ *﴾

﴿قَالُوا بَلْ وَجَدْنَا آبَاءَنَا كَذَلِكَ يَفْعَلُونَ﴾

“A ju dëgjojnë ata juve kur i luteni? Ose: A u sjellin juve dobi apo dëm? Ata thanë: kështu i gjetëm duke vepruar baballarët tanë”. [esh Shua’ra: 72-74].

Ibn Kethiri thotë: “Ata e pranuan që idhujt e tyre nuk mund të bëjnë asgjë nga të përmendurat, dhe se ata iu luteshin idhujve të tyre pasi që kështu gjetën baballarët e tyre”.

Lutja e të vdekurit nuk sjell gjë veç lodhjes dhe gjynahut

Kush i lutet të vdekurit me shpresë se ai do t'i sjell mirësi apo do t'i largojë fatkeqësi, nuk fiton gjë veçse gjynahut që ai bën dhe lodhjes.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿يَدْعُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُ وَمَا لَا نَنْفَعُهُ، ذَلِكَ هُوَ الضَّلَالُ الْبَعِيدُ﴾*

﴿يَدْعُوا لِمَنْ ضَرُّهُ أَقْرَبُ مِنْ نَفْعِهِ، لَيْسَ الْمَوْلَىٰ وَلَيْسَ الْعَشِيرُ﴾

“Ai në vend të Allahut lut atë që nuk mund t'i bëj as dëm e as dobi, kjo është humbja pa mbarim.

Lut atë që dëmin e tij e ka më afër se dobinë e tij. Sa ndihmëtar e shok i keq që është”. [el Haxh: 13-14].

Të shpresuarit dhe kërkimi i ndihmës nga krijesat – të gjalla apo të vdekura qofshin, është ulje dhe poshtërim.

Imam Ahmed bin Hanbeli thoshte: “O Allah, sikurse ma ke ruajtur fytyrën që të mos i bie në

sëxhde askujt veç Teje; ruaje fytyrën time që të mos i kërkohet askujt, e nuk e largon të keqen dhe nuk e sjell të mirën askush tjetër veç Teje”.

Kush i lutet dikujt veç Allahut për ta shpëtuar nga një pikëllim Allahu do ta ndëshkojë me një pikëllim akoma më të madh

Nuk ka njeri që i lutet dikujt veç Allahut, e lidh zemrën me të apo e cyt Shejtani që t'a lidh zemrën me dikë tjetër veç Allahut, veçse do të pllakoset nga trishtimi dhe pikëllimi, çka do e vetëdijësojë se ai të cilit i është lutur nuk mund} ta ndihmojë dhe do i nxjerr në pah dobësinë e tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ قُلْ أَرَأَيْتَكُمْ إِنْ أَتَاكُمْ عَذَابُ اللَّهِ أَوْ أَتَتْكُمُ السَّاعَةُ أَغَيْرَ اللَّهِ
تَدْعُونَ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ * بَلْ إِيَّاهُ تَدْعُونَ فَيَكْشِفُ مَا تَدْعُونَ
إِلَيْهِ إِنْ شَاءَ وَتَنْسَوْنَ مَا تُشْرِكُونَ ﴾

“Thuaju: Nëse ju vjen dënimi nga Allahu ose ju vjen kijameti, më tregoni - nëse jeni të sinqertë -, a do t'i luteni për ndihmë dikujt tjetër veç Allahut?

Jo, vetëm Atij (Allahut) do t'i luteshit, e nëse do Ai, ju heq atë për çka i luteni, e do t'i harronit ata (zota) që ia shoqëronit (në adhurim)”. [el

En'am: 40-41].

Ai i cili është në dijeni se Allahut i takon sundimi absolut, Ai zotëron gjithçka e nuk ka nevojë për asnjë nga krijesat; ai nuk pret mirësi veçse nga Allahu, e nuk shpreson veçse tek Ai.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿قُلْ أَدْعُوا الَّذِينَ زَعَمْتُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَا يَمْلِكُونَ مِنْ قَالِ ذَرَّةً فِي السَّمَوَاتِ
وَلَا فِي الْأَرْضِ وَمَا لَهُمْ فِيهَا مِنْ شَرِكٍ وَمَا لَهُ مِنْهُمْ مَنْ ظَاهِرٍ﴾

“Thuaj: Thirrini ata, të cilët i menduat për zota veç Allahut! Ata nuk posedojnë as edhe një grimcë, as në qiej e as në tokë, dhe as që kanë në to ndonjë pjesë (me ortakëri), dhe Ai nuk ka prej tyre ndonjë ndihmues”. [Sebe: 22].

Gjendja e atij që i lutet dikujt veç Allahut gjatë agonive të vdekjes

Gjatë agonive të vdekjes cilido që ka adhuruar dikë tjetër veç Allahut kërkon të shfajësohet nga veprimi i tij:

﴿الَّذِينَ تَتَوَفَّيْهُمْ الْمَلَائِكَةُ ظَالِمِي أَنْفُسِهِمْ فَأَلْقَوْا السَّلَامَ
مَا كُنَّا نَعْمَلُ مِنْ سُوءٍ﴾

“Ata të cilët, duke qenë mizorë të vetvetes së tyre, engjëjt ua marrin shpirtin, e ata shprehin dorëzimin (shfaqin nënshtrimin dhe bindjen ndaj Allahut në momentin e vdekjes duke thënë): Ne nuk ishim që bëmë ndonjë të keqe!”. [en Nahl: 28].

Ditën e gjykimit do të zbardhet e vërteta e ata do ta shohin praktikisht që atyre të cilëve iu luteshin nuk mund t'i ndihmojnë, e të luturit do të distancohen nga lutësit.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿حَتَّىٰ إِذَا جَاءَهُمْ رَسُولُنَا يُتَوَفَّوْنَهُمْ قَالُوا أَيْنَ مَا كُنْتُمْ تَدْعُونَ مِن
دُونِ اللَّهِ قَالُوا ضَلُّوا عَنَّا﴾

“Kur t’u vijnë atyre të dërguarit tanë (melaiket) t’ua marrin shpirtin e t’iu thonë: Ku janë ata që veç Allahut i luteshit? Ata thonë: Kanë humbur prej nesh”. [el A’raf: 37].

“Kanë humbur prej nesh”: kanë ikur, e nuk shpresojmë më prej tyre asgjë.

Ai i cili i lutet dikujt veç Allahut: Allahu hidhërohet prej tij dhe e fut atë përjetësisht në zjarrin e Xhehennemit.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë: ***“Kush vdes duke lutur dikë tjetër veç Allahut do të hyj në zjarr”***. [Tr. Buhariu (4497) dhe Muslimi (92)].

Dëshira e Shejtanit është që njeriu t'i lutet dikujt tjetër veç Allahut

Lutja është prej adhurimeve më madhore, me anë të saj dallohet ai i cili e njëson Allahun nga ai i cili i bën atij shirk.

Lutja është prej dyerve që Shejtani e ka të lëhtë që nëpërmjet saj të prish fenë e njerëzve.

Ibn Kajim el Xheuzije thotë: “Lutja e të vdekurve, kërkimi i ndihmës prej tyre dhe shkuarja tek ata në rast nevoje, është origjina e shirkut në mbarë botën”.

Muslimani ia dedikon zemrën e tij, adhurimin dhe veprimet vetëm Allahut, dhe bën dallim mes Allahut e krijesave, njeh dhe i jep secilit atë që i takon duke mos e kaluar hakun e dikujt tek dikush tjetër.

Allahut i takojnë të gjitha adhurimet, lutja, frika, shpresa ... etj, ndërsa njerëzit e mirë meritojnë dashurinë, ndjekjen, ruajtjen e nderit të tyre dhe fjalët e mira.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿فَأَقِمْ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا فِطْرَتَ اللَّهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا لَا تَبْدِيلَ
لِخَلْقِ اللَّهِ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ﴾

“Përqëndro veten në fe, i larguar prej çdo të kote, ajo është natyrshmëria e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s’ka ndryshim të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë”. [er Rrum: 30].

Teuhidi është gjëja më e vlefshme e njeriut

Gjëja më e shtrenjtë që mund të ketë njeriu është teuhidi dhe mirësia më e madhë është që ai të qëndroj i paluhatur në të, derisa të takohet me Allahun. Pak nga teuhidi nëse është i saktë e shpëton njeriun nga përjetshmëria në zjarr, ndërsa teuhidi i plotë e pengon hyrjen në zjarr.

E për këtë shkak, Shejtani provon mënyra të ndryshme të mashrtimit dhe hedhjes së dyshimeve me qëllim që t'i devijoj njerëzit nga feja e pastër, e çdo dyshim që mund t'i vij në mendje njeriut, në të ka gjëra që mund ta joshin të bjerë pre e tij.

Kush dëshiron të shpëtoj le të ruaj teuhidin dhe besimin duke lexuar e medituar Kur'anin, duke mësuar dije fetare dhe duke qëndruar larg dyshimeve.

Lusim Allahun që t'na pajisë me dije të dobishme, punë të mira dhe t'i lutemi veç Atij.

Falja (salavatet) dhe paqja (selami) e Tij qofshin mbi Profetin Muhamed ﷺ, familjen dhe shokët e tij.

Përmbajtja

Feja islame në thelb është kryerja e veprave me sinqeritet vetëm	7
për Allahun	7
Feja Islame bazohet mbi lutjen e Allahut, e askujt tjetër veç Tij	9
Ndëshkimi i atij që është mendjemadh karshi lutjes së Allahut	11
Lutja është i gjithë adhurimi	12
Rëndësia e dedikimit të lutjes	13
vetëm Allahut	13
Lutja e Allahut është tregues i imanit	14
Vetëm Allahu i përgjigjet lutjes	15
Profetët nuk lusin veçse Allahun	18
Dobitë e lutjes së Allahut	22
Prej shenjave të personit që e njëson Allahun	23
Profetët e Allahut nuk kanë urdhëruar askënd që t’u lutet atyre	24
Lutja e dikujt tjetër veç Allahut është gjynahu më i	

madh.....	26
I vdekuri nuk dëgjon nëse dikush i lutet.....	29
“E ata që ju i luteni në vend të Allahut, nuk posedojnë as sa një cipë të hurmës. Nëse i luteni, ata nuk dëgjojnë thirrjen tuaj, e nëse do e dëgjonin, nuk mund t’ju përgjigjen”. [Fatir: 13-14].	29
Ai i cili i lutet të vdekurit është i bindur që i vdekuri nuk dëgjon e nuk mund të sjell dobi	31
Lutja e të vdekurt nuk sjell gjë veç lodhjes dhe gjynahut.....	32
Kush i lutet dikujt veç Allahut për ta shpëtuar nga një pikëllim Allahu do ta ndëshkojë me një pikëllim akoma më të madh	34
Gjendja e atij që i lutet dikujt veç Allahut gjatë agonive të vdekjes	36
Dëshira e Shejtanit është që njeriu t’i lutet dikujt tjetër veç Allahut.....	38
Teuhidi është gjëja.....	40
më e vlefshme e njeriut.....	40

Shoqata "TALIB EL ILM" për botime
00966506090448





Lexo në këtë broshurë:

- ❖ Lutja është një adhurim tepër i madh, i rëndësishëm për çdo musliman, dhe sinqeriteti që tregohet në lutje tregon gradën e teuhidit të njeriut.
- ❖ Allahu i Lartësuar do që njerëzit t'i luten Atij në ç' do kohë dhe urren atë që i lutet dikujt tjetër veç Tij.
- ❖ Lutja e Allahut -e askujt tjetër veç Tij- është prej rrugës dhe traditës së profetëve dhe besimtarëve të mirë.
- ❖ Lutja e dikujt tjetër veç Allahut qoftë i gjallë apo i vdekur është shirk, dhe lutësi nuk merr nga kjo lutje nga asnjë dobi e përfitim.
- ❖ Gjynahu më i madh është lutja e dikujt tjetër bashkë me Allahun.
- ❖ Teuhidi (njësimi i Allahut) është gjëja më e shtenjë që njeriu posedon, e kush i bën Allahut shirk në lutje e ka humbur teuhidin.

مترجم بالأبانية